

ЛОГО

**PLANI STRATEGJIK,
2023 – 2025**

Shkup, janar 2023

1.1. HYRJE

Dokumenti bazë i cili i rregullon prioritetet strategjike të Entit Shtetëror të Statistikës në periudhën 2023-2025 është Plani Strategjik i Entit Shtetëror të Statistikës, 2023-2025. Realizimi i programeve dhe nënprogrameve të përcaktuara duhet të siguroj:

- Kryerjen e detyrimeve të Entit Shtetëror të Statistikës, të përcaktuara në Programin për Hulumtime Statistike për periudhën 2023-2027 dhe

- Realizimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut lidhur me integrimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në BE, përkatësisht realizimin e detyrimeve nga Programi Nacional për Miratimin e Legjislacionit Evropian (NPAA) .

Gjatë përgatitjes së Planit Strategjik janë respektuar plotësisht: Ligji për Statistikat Shtetërore dhe Programi Pesëvjeçar për Hulumtime Statistike, 2023-2027.

Gjithashtu, janë marrë parasysh dokumentet përkatëse nga Komisioni Evropian, të cilat përcaktojnë prioritetet strategjike të Sistemit Statistikor Evropian dhe sipas të cilave monitorohet ecuria e Entit Shtetëror të Statistikës. Janë marrë parasysh edhe rekomandimet nga vlerësimi i parneritetit (Peer Review) i Komisionit evropian për progresin e implementimit të Kodit të Punës së Statistikave Evropiane, si dhe rekomandimet nga misionet e rregullta vjetore të Eurostatit (Shërbimi Statistikor i Komisionit Evropian), rekomandimet nga raporti vjetor i Komisionit Evropian për të vlerësuar progresin e Kapitullit 18 – Statistika

në lidhje me harmonizimin me standardet e BE-së.

1.2. ANALIZA E GJENDJES NË ENTIN SHETËROR TË STATISTIKËS

1.2.1. BAZA FILLESTARE

Enti Shtetëror i Statistikës është një organizatë e pavarur e menaxhimit profesional i cili, bazuar në metodat dhe njohuritë shkencore, u siguron përdoruesve të dhëna për ekonominë, demografinë, jetën sociale, mbrojtjen e mjedisit dhe fushave të tjera. Të dhënat statistikore zyrtare, të paraqitura në forma të ndryshme desiminimi, janë të mbrojtura nga çdo ndikim dhe të gjithë përdoruesit kanë qasje të barabartë.

Enti Shtetëror i Statistikës është përgjegjës për prodhimin e statistikave shtetërore në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe është koordinator i sistemit statistikor në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Enti Shtetëror i Statistikës është kompetent për koordinimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e statistikave. Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e statistikave ka të bëjë me aplikimin e normave dhe standardeve ndërkombëtare në fushën e statistikave në sistemin statistikor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe diseminimin e të dhënave statistikore për vendin tek organizatat statistikore evropiane dhe ndërkombëtare si dhe organizata të tjera.

1.2.2. ANALIZA E KORNIZËS LIGJORE

Kompetenca dhe fushëveprimi i punës janë të rregulluara me Ligjin për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/00, 44/02, 82/08, 167/10 dhe 51/11 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/19 dhe 110/19) dhe me Ligjin për statistikat shtetërore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 54/97, 21/07, 51. /11, 104/13, 42/14, 192/15, 27/16, 83/18 dhe 220/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 31/20). Akti nënligjor kryesor në të cilin përcaktohen hulumtimet statistikore e që zbatohen në një periudhë pesëvjeçare është Programi për hulumtimet statistikore për periudhën 2023-2027.

1.2.3. ANALIZA E BURIMEVE

1.2.3.1. BURIMET FINANCIARE

Enti Shtetëror i Statistikës financohet nga mjetet e siguruara nga buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, Programi 10 - Administratë dhe Programa 20 - Hulumtime statistikore. Mjete mjaftë të rëndësishme shtesë sigurohen nëpërmjet IPA fondeve dhe donatorëve të tjerë (SIDA etj.).

1.2.3.2. BURIMET NJERËZORE

Në Entin Shtetëror të Statistikës, më datë 31.12. 2022 numërojmë gjithsej 206 nëpunës administrativ, prej të cilëve 172 janë me arsim të lartë, ndërsa 34 prej tyre me arsim të mesëm.

Në tabelën e mëposhtme renditen të dhënat për numrin e të punësuarve sipas nivelit arsimor dhe strukturës gjinore.

Të punësuar nëpunës administrativë në ESHS deri më 31 dhjetor 2022

Vendi i punës	i lartë		I lartë (3 vjeçar)		i mesëm		fillor		GJITHSEJ	
	meshkuj	femra	meshkuj	femra	meshkuj	femra	meshkuj	femra	meshkuj	femra
	Udhëheqës	14	17	0	0	0	0	0	0	14
Joudhëheqës	48	93	0	0	16	18	0	0	64	111
Gjithsej	62	110	0	0	16	18	0	0	78	111

1.2.4. ANALIZA PESTLE E FAKTORËVE POLITIK, EKONOMIK, SOCIAL, TEKNOLOGJIK, JURIDIK DHE MJEDISOR

Nga aspekti i faktorëve politik që kanë ndikim në funksionimin e Entit Shtetëror të Statistikës, më të rëndësishmit janë:

- ndryshimet në Qeveri, perceptimi i tyre për vendin dhe rolin e ESHS-së në sistemin dhe nivelin e njohurive për rëndësinë dhe nevojën e statistikave në çdo shoqëri moderne;

- prioritetet dhe qëllimet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe
- konkluzionet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilat duhet të zbatohen nga Enti Shtetëror i Statistikës.

Faktorët më të rëndësishëm ekonomik janë:

- niveli i mjeteve financiare të siguruara nga buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilat janë të nevojshme për realizimin e kompetencave të ESHS-së dhe
- sigurimi i burimeve financiare nga donatorë të huaj, pa të cilat Enti nuk do të mund të realizonte një pjesë të kompetencave.

Faktorët më të rëndësishëm social janë:

- perceptimi i ofruesve dhe i përdoruesve të të dhënave statistikore për Entin Shtetëror të Statistikës dhe
- informimi i publikut për rezultatet e punës së Entit dhe bartësve të autorizuar.

Si faktorë me karakter teknologjik, më të rëndësishme janë:

- Enti është plotësisht i varur nga ecuria e TI-së dhe teknologjive tjera në vend dhe në botë dhe implementimi i saj në aktivitetet e Entit (prodhimi i të dhënave statistikore, etj.).

Për sa i përket faktorëve juridik, më të rëndësishëm janë:

- aktet e përgjithshme ligjore dhe nënligjore dhe
- zbatimin e legjislacionit të BE-së (rregulloret dhe direktivat) në legjislacionin statistikor të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Faktori më i rëndësishëm ekologjik është:

- detyrimi i Entit për mbrojtjen e mjedisit jetësor

Faktorët politik	Faktorët ekonomik	Faktorët social	Faktorët teknologjik	Faktorët juridik	Faktorët ekologjik
------------------	-------------------	-----------------	----------------------	------------------	--------------------

Prioritetet dhe qëllimet strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut	Mjetet financiare të siguruar nga Buxheti i Republikës së Maqedonisë së Veriut, të cilat janë të nevojshme për realizimin e kompetencave të saj	Perceptimi i ofruesve dhe përdoruesve të të dhënave statistikore për Entin Shtetëror të Statistikës	Enti është tërësisht i varur nga ecuria e TI-së dhe teknologjive tjera në vend dhe në botë dhe zbatimi i saj në aktivitetet e Entit (prodhimi i të dhënave statistikore, etj.)	Aktet e përgjithshme ligjore dhe nënligjore	Detyrimi i Entit për mbrojtjen e mjedisit jetësor
Konkluzionet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut të cilat duhet të zbatohen nga Enti Shtetëror i Statistikës	Sigurimi i burimeve financiare nga donatorë të huaj, pa të cilët Enti nuk do të mund të realizojë disa nga përgjegjësitë	Informimi i publikut për rezultatet e punës së Entit dhe bartësve të autorizuar		Zbatimi i legjislacionit të BE-së (rregulloret dhe direktivat) në legjislacionin statistikor të Republikës së Maqedonisë së Veriut	

1.2.5. ANALIZA SWOT NË NIVEL TË ENTIT SHETËTOR TË STATISTIKËS

SWOT (Strengths, Weaknesses, Opportunities, Threats) paraqet analizë të pikave të forta, dobësive, kërcënimeve dhe mundësive, përmes së cilës mund të perceptohet ndikimi i faktorëve të jashtëm dhe të brendshëm në funksionimin e Entit Shtetëror të Statistikës.

Përparësitë e Entit Shtetëror të Statistikës janë:

- angazhimi i menaxhmentit të Entit për realizimin e përcaktimeve strategjike të Qeverisë për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në BE,

- vendosja e strukturës organizative dhe modelit të funksionimit në përputhje me praktikën e mira të BE-së dhe

- ndërgjegjësimi dhe përkushtimi i stafit për nevojën e harmonizimit të statistikës së Maqedonisë me obligimet e BE-së dhe ato ndërkombëtare.

Dobësitë më të rëndësishme janë:

- pamundësia e plotësimin në kohë e vendeve të lira të punës;

- balancimi i pamjaftueshëm i detyrimeve dhe burimeve në institucion;

- fleksibilitet i dobët, respektivisht pamundësia për t'u përshtatur shpejt me ndryshimet (organizative, modernizimi i TI-së, vendosja e mjeteve dhe metodave të reja të punës, etj.).

Mundësitë për përmirësimin e pozitës së Entit janë:

- përfshirja e kapitullit 18-Statistika në grupin e parë në procesin e negociatave;

- nevoja e shtuar për të dhëna statistikore si mbështetje në procesin e negociatave për të gjithë kapitujt e tjerë;

- forcimi i identitetit korporativ të institucionit si institucion profesional dhe i pavarur dhe

- përdorimi efikas i të dhënave statistikore nga Qeveria dhe organet qeveritare në krijimin e politikave të ndryshme.

Rreziku (kërcënimet):

- largimi i kuadrit profesional;

- mospajtimi i burimeve financiare për mbështetjen e përhershme të harduerit dhe softuerit në institucion dhe

- mosarritja e qëndrueshmërisë të mbështetjes profesionale dhe teknike nga donatorët e BE-së.

<p>Përparësitë (anët e forta)</p> <ul style="list-style-type: none"> - angazhimi i menaxhmentit të Entit për realizimin e përcaktimeve strategjike të Qeverisë për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në BE; -krijimi i strukturës organizative dhe modelit të funksionimit në përputhje me praktikën e mira të BE-së; - vetëdijësi dhe përkushtimi i stafit për nevojën e harmonizimit të statistikave të Maqedonisë me obligimet e BE-së dhe ato ndërkombëtare. 	<p>Dobësitë (dobësitë)</p> <p>pamundësia për të plotësuar në kohë vendet e lira të punës</p> <ul style="list-style-type: none"> - balancimi i pamjaftueshëm i detyrimeve dhe burimeve në institucion; - fleksibilitet i dobët, respektivisht pamundësia për t'u përshtatur shpejt me ndryshimet (organizative, modernizimi i TI-së, vendosja e mjeteve dhe metodave të reja të punës, etj.).
<p>Mundësitë</p> <ul style="list-style-type: none"> - përfshirja e kapitullit 18-Statistika në grupin e parë në procesin e negociatave; 	<p>Rreziqet (kërcënimet)</p> <ul style="list-style-type: none"> - largimi i kuadrit profesional; - mospajtimi i burimeve financiare për mbështetjen e përhershme të harduerit dhe softuerit në institucion dhe

<p>- nevoja e shtuar për të dhëna statistikore si mbështetje në procesin e negociatave për të gjithë kapitujt e tjerë;</p> <p>- forcimi i identitetit korporativ të institucionit si institucion profesional dhe i pavarur dhe</p> <p>- përdorimi efikas i të dhënave statistikore nga Qeveria dhe organet qeveritare në krijimin e politikave të ndryshme.</p>	<p>- mosarritja e qëndrueshmërisë së mbështetjes profesionale dhe teknike nga donatorët e BE-së.</p>
---	--

1.3. MISIONI

Enti Shtetëror i Statistikës prodhon dhe bën diseminimin e të dhënave statistikore zyrtare për ekonominë dhe shoqërinë e Maqedonisë si bazë për procesin e vendimmarrjes bazuar në informacione relevante.

1.4. VIZIONI

Vizioni ynë është të njihemi si një institucion profesional dhe efikas dhe i cili ofron të dhëna statistikore cilësore, të krahasueshme ndërkombëtarisht në përputhje me nevojat e përdoruesve.

1.5. VLERAT

Vlerat e Entit Shtetëror të Statistikës janë:

Pavarësi profesionale

Profesionalizëm dhe ekspertizë

Neutralitet dhe objektivitet

Përkushtim ndaj cilësisë

Besueshmëri statistikore

Përmirësim të vazhdueshëm të aftësive profesionale të punonjësve

1.6. DETYRAT DHE OBLIGIMET E ENTIT SHTETËROR TË STATISTIKËS

Enti, në kuadër të kompetencave të tij, kryen këto punë profesionale:

- I kordinon aktivitetet e statistikës shtetërore në kuadër të Sistemit statistikor kombëtar;
- I përgatit dhe përshkruan instrumentet për hulumtime statistikore (metodologjitë, udhëzimet, formularët, listat koduese, etj.);
- Jep mendim bartësve të autorizuar për bazat metodologjike të hulumtimeve që janë në kompetencë të tyre;
- Jep mendim gjatë prezantimit të të dhënave të reja dhe gjatë koleksioneve ekzistuese të të dhënave të cilat mund të jenë burim i të dhënave për statistikat shtetërore;
- Ngrit iniciativa dhe jep propozime për plotësime përmbajtësore në grupe të reja dhe koleksioneve të reja të të dhënave që përdoren për hulumtime statistikore në përputhje me

ligjin dhe Programin pesëvjeçar për hulumtime statistikore, 2023-2027;

- Bashkëpunon me bartësit e autorizuar që kryejnë hulumtime statistikore në fushën e statistikave shtetërore në kuadër të kompetencës së tij;
 - Vendos, drejton dhe mbanë koleksionet e të dhënave statistikore;
 - Përgatit standardet kombëtare statistikore;
 - Përcakton nevojat e të dhënave statistikore;
 - Përcakton masat organizative dhe teknike për mbrojtjen e të dhënave konfidenciale;
 - Mbledh dhe përpunon të dhëna statistikore;
 - Bën analizë të të dhënave statistikore;
 - Mban dhe shpërndan të dhëna statistikore;
 - Përbush detyrimet ndërkombëtare në fushën e statistikave;
 - Koordinon dërgimin e të dhënave statistikore tek organizatat ndërkombëtare;
 - Kryen shërbime në fushën e statistikave për nevojat e përdoruesve, me kërkesë të tyre;
 - Bën promovimin e statistikave
- Realizon projekte në fushën e statistikave shtetërore në mënyrë të pavarur dhe në bashkëpunim me bartësit e tjerë të autorizuar;
- Kryen mbikqyrje në realizimin e dispozitave të Ligjit për statistikat shtetërore;
 - Kryen punë të tjera të përcaktuara me Ligjin për statistikat shtetërore dhe ligje të tjera.

1.7. SPECIFIKIMET E ENTIT SHTETËROR TË STATISTIKËS

Enti Shtetëror i Statistikës është organizatë e pavarur profesionale, kompetencat dhe fushëveprimet të së cilës janë të rregulluara me Ligjin për organizimin dhe punën e organeve të administratës shtetërore ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 58/00, 44/02, 82/08. , 167/10 dhe 51/11 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 96/19 dhe 110/19) dhe me Ligjin për Statistikat Shtetërore ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 54/ 97, 21/07, 51/11, 104/13, 42/14, 192/15, 27/16, 83/18 dhe 220/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 31/20) .

Në përputhje me Ligjin për statistikat shtetërore, Enti Shtetëror i Statistikës, bazuar në metodat dhe njohuritë shkencore, u ofron përdoruesve të dhëna për ekonominë, demografinë, jetën sociale, mbrojtjen e mjedisit dhe fushave të tjera. Të dhënat statistikore zyrtare, të paraqitura në forma të ndryshme desiminimi, janë të mbrojtura nga çdo ndikim dhe të gjithë përdoruesit kanë qasje të barabartë.

Enti Shtetëror i Statistikës është përgjegjës për prodhimin e statistikave shtetërore (zyrtare) në Republikën e Maqedonisë së Veriut dhe është koordinator i sistemit statistikor në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Enti Shtetëror i Statistikës e kryen këtë rol në bashkëpunim me bartësit e autorizuar në sistemin statistikor, të përcaktuar në Programin pesëvjeçar për hulumtime statistikore. Në kryerjen e

funksiioneve të tij, Enti Shtetëror i Statistikës i kushton vëmendje të veçantë konfidencialitetit të të dhënave statistikore. Të dhënat e mbledhura nga anketat statistikore apo nga burimet administrative dhe burimet e tjera janë konfidenciale dhe përdoren ekskluzivisht për qëllime statistikore dhe me përjashtim të plotë të mundësisë së zbulimit të të dhënave individuale për personat fizik dhe subjektet afariste.

Enti Shtetëror i Statistikës është përgjegjës për koordinimin e bashkëpunimit ndërkombëtar në fushën e statistikave. Bashkëpunimi ndërkombëtar në fushën e statistikave ka të bëjë me aplikimin e normave dhe standardeve ndërkombëtare në fushën e statistikave në sistemin statistikor të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe desiminimin e të dhënave statistikore të vendit tek organizatat statistikore evropiane dhe ndërkombëtare dhe organizata të tjera.

1.8. STRUKTURA E BIROVE SHETETËRORE TË STATISTIKAVE

Organizativisht, Enti Shtetëror i Statistikës është i organizuar në 9 sektorë me gjithsej 42 njësi. Tre njësi janë të pavarura, respektivisht jashtë sektorëve. Në territorin e vendit janë krijuar tetë njësi rajonale që mbulojnë rajone të caktuara. Struktura organizative është vendosur në vitin 2020. Skema e strukturës gjendet në webfaqen e Entit (<http://www.stat.gov.mk/ZaNas.aspx?id=4>).

1.9. PRIORITETET DHE QËLLIMET E ENTIT SHETETËROR TË STATISTIKËS

Për periudhën 2023 – 2025 Enti Shtetëror i Statistikës përcaktoi këto prioritete:

- Integrimi i sistemit statistikor të Maqedonisë në sistemin statistikor evropian;
- Forcimi i mjedisit institucional dhe infrastrukturës statistikore;
- Zhvillimi i partneriteteve strategjike dhe
- Menaxhimi i cilësisë.

1.9.1. Integrimi në Sistemin statistikor evropian

Qëllimet:

- Harmonizimi i të dhënave statistikore zyrtare me Statistical Requirement Compendium (acquis statistikore);
- Sigurimi i të dhënave statistikore për mbështetjen e procesit të negociatave të Republikës së Maqedonisë së Veriut për anëtarësim në BE dhe
- Prodhimi i të dhënave statistikore cilësore, në përputhje me parimet e COP-it.

Afati i planifikuar për realizimin e prioritetit: deri në vitin 2025.

1.9.2. Forcimi i mjedisit institucional dhe infrastrukturës statistikore

Qëllimet:

- Forcimi i pavarësisë profesionale;
- Forcimi i rolit koordinues të Entit në sistemin statistikor;
- Avancimi i punës ekipore, komunikimi i brendshëm dhe transferimi i njohurive dhe
- Inovacioni dhe zhvillimi.

Afati i planifikuar për realizimin e prioritetit: deri në vitin 2025.

1.9.3. Zhvillimi i partneriteteve strategjike

Qëllimet:

- Ruajtja e partneriteteve të vendosura strategjike dhe
- Zhvillimi i bashkëpunimit dhe partneritetit në të gjitha nivelet dhe me palët e ndryshme të prekura.

Afati i planifikuar për realizimin e prioritetit: deri në vitin 2025.

1.9.4. Menaxhimi i cilësisë

Qëllimet:

- Aplikimi i një sistemi të menaxhimit të cilësisë bazuar në Kornizën evropiane për Sigurimin e cilësisë - QAF) dhe parimet e Kodeksit për punë të statistikës evropiane.

Afati i planifikuar për realizimin e prioritetit: deri në vitin 2026.

1.10. VËSHTRIMI I PËRGJITHSHËM I REZULTATEVE TË ARRITURA NGA ENTI SHTETËROR I STATISTIKËS NË VITIN 2021

Në Planin strategjik të Entit Shtetëror të Statistikës për periudhën 2021-2023 janë përcaktuar këto programe për realizimin e prioritetëve strategjike të Entit Shtetëror të Statistikës (në tekstin e mëtejshëm ESHS).

1. Statistikat sektoriale
2. Zbatimi i Regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në vitin 2021
3. Mjedisi institucional
4. Infrastruktura statistikore
5. Bashkëpunimi me ofruesit e të dhënave dhe bartësit e grupeve të të dhënave
6. Bashkëpunimi dhe komunikimi me përdoruesit
7. Përkushtimi ndaj cilësisë

Realizimi i këtyre programeve ka të bëjë me prioritetin strategjik të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021 për zhvillimin e suksesshëm të bisedimeve me Bashkimin Evropian, i cili gjendet në Vendimin për përcaktimin e prioritetëve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2021, gjegjësisht qëllimet prioritare: fillimi dhe menaxhimi i suksesshëm i procesit negociator për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë së

Veriut në Bashkimin Evropian, zbatimi i politikës makroekonomike që synon ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, rritjen e konkurrencës së ekonomisë dhe rritjen e punësimit.

1. Në programin e Statistikave sektoriale janë përcaktuar nënprogramet e mëposhtme:

1.1 Përmirësimi i procesit të prodhimit të statistikave sektoriale

1.2 Matja e cilësisë së njoftimeve

Në kornizat e nënprogrameve të përcaktuara janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

Statistikat sociale

- Me rregulloren e Sistemit Evropian të Statistikave të Integruara për Mbrojtje Sociale janë të përfshira fushat e mëposhtme: forca e punës, të ardhurat dhe kushtet e jetesës, shëndeti, arsimi dhe trajnimi, përdorimi i teknologjive të informacionit dhe komunikimit dhe përdorimi i kohës. Në Njësinë e Tregut të Punës me zbatim e Rregullores është filluar që nga viti 2021. Rregullorja filloi të zbatohet në fushat: Forca e Punës (Anketa e Forcave të Punës, modulet ad hok dhe Arsimi dhe Trajnimi (Anketa e Arsimit të të Rriturve). Metodologjia dhe instrumentet për Anketën e Forcës së Punës u përgatitën në përputhje me Rregulloren e re. Është zbatuar edhe moduli ad hok 2021 - Emigrantët dhe pasardhësit e tyre në tregun e punës. Metodologjia dhe instrumentet për fushën e Arsimit dhe trajnimit (Adult Education Survey) janë përgatitur sipas rregullores IESS. Aktivitetet në terren për këtë Anketë ishin planifikuar për vitin 2022, dhe dërgimi i të dhënave në Eurostat për vitin 2023.

Me implementimin e Rregullores në fushat e përmendura duhet të përmirësohet cilësia e grupeve të të dhënave dhe treguesve social të cilat janë thelbësorë për vendimmarrje.

Statistikat bujqësore

- Në fushën e statistikave bujqësore është studiuar rregullorja e BE-së 2018/1091 për statistikën e integruara bujqësore dhe e njëjta do të zbatohet gjatë përgatitjeve dhe zbatimit të Regjistrimit të bujqësisë, 2023.
- Me qëllim sigurimin e të dhënave të përditësuara dhe përkatëse statistikore për zjarret pyjore që përfshin territorin e shtetit, Enti Shtetëror i Statistikës, në bashkëpunim me NP "Pyjet Nacionale", zbatuan hulumtim statistikor shtesë për zjarret pyjore dhe publikoi rezultatet.
- Bazuar në Udhëzimet e rishikuara për përgatitjen e raporteve të cilësisë, ka filluar përgatitja e Raporteve të cilësisë sipas strukturës SIMS 2.0 për hulumtime statistikore në fushën e statistikave bujqësore, të mjedisit, të transportit dhe statistikave të energjisë.

Statistikat e afariste

- Statistikat afariste ishin në proces të përshtatjes me dispozitat e EBS (European Business Statistics – FRIBS), rregulloren e statistikave afariste, respektivisht Rregulloren e BE-së 2019/2152 të Parlamentit dhe Këshillit Evropian të 27 nëntorit vitit 2019 për statistika evropiane afariste, me të cilën shfuqizohen 10 akte ligjore në fushën e statistikave afariste.
- Në fushën e Regjistrin statistikor të bizneseve, i cili është bazë për statistikat afariste, janë realizuar aktivitete në kuadër të projektit IPA 2017, të cilat kanë përmirësuar funksionalitetin e Regjistrin në drejtim të aspekt të sigurimit të njësive statistikore të detyrueshme dhe variablave të tyre (sipas EBS), plotësimin e tij me të dhëna administrative, të dhëna nga hulumtimet statistikore dhe përdorimin e tij për nevojat e hulumtimeve statistikore (në radhë të parë, për demografinë e ndërmarrjeve dhe për statistikat FATS).
- Është përcaktuar mënyra e krijimit të njësive në Regjistrin statistikor të bizneseve që nuk janë përfshirë deri më tani, përkatësisht ndërmarrjet komplekse (njësi të shumta legale të lidhura me marrëdhënie pronësie në një ndërmarrje komplekse) dhe KAU – njësia sipas llojit të veprimtarisë.
- Grupet e ndërmarrjeve, të cilat deri më tani menaxhoheshin veçmas nga Regjistri, u bënë pjesë e SDR.
- Në mungesë të një burimi administrativ të të dhënave, u përcaktua mënyra e përcaktimit të variablave për njësitë lokale që mungojnë: numri i punonjësve dhe qarkullimi.
- STS dhe SDS, respektivisht statistikafatshkurtra dhe statistikafstrukturore të biznesit, u përshtatën gjithashtu me dispozitat e rregullores EBS, në drejtim të rritjes së shtrirjes së variablave të kërkuara sipas Rregullores, si dhe grupin e të dhënave të cilët dërgohen në Eurostat. Në kuadër të IPA 2017 – aktivitetet e planifikuara për STS nuk u realizuan plotësisht për shkak të angazhimit të shtuar të të gjithë punonjësve të Entit Shtetëror të Statistikës lidhur me realizimin e Regjistrimit të popullsisë 2021. Për këto arsye është planifikuar që këto aktivitete të realizohen me IPA-në e re 2019. Të gjitha aktivitetet në fushën e Statistikave afatshkurtra (STS) në vitin 2021 kishin për qëllim realizimin e hulumtimeve tashmë ekzistuese dhe publikimin dhe dorëzimin e tyre të rregullt në Eurostat.
- Filloi vendosja e sistemit të prodhimit të statistikave të tregtisë ndërkombëtare të shërbimeve (ITSS), me ç'rast është kryer hulumtim pilot dhe të dhënat e këtij hulumtimi pilot janë përpunuar dhe janë dorëzuar në Eurostat.

Statistikat makroekonomike

Në fushën e statistikave makroekonomike janë bërë përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e të dhënave në përputhje me SNS 2008 (System of National Accounts, SNA 2008) dhe ESS 2010 (European System of Accounts, ESA 2010) dhe transmisionin e tyre në Eurostat:

- Vazhdimisht janë dërguar të dhënat për tabelat kryesore sipas Programit ESS 2010 të Eurostat-it për dërgimin e të dhënave tremujore (tabelat T0101 dhe T0102) në përputhje me Rregulloren nr. 549/2013.

- Janë përgatitur dhe dërguar në Eurostat tabelat (T1001 dhe T1002) për komponentët e PBB-së sipas veprimtarive të NKD Rev.2 në nivel kombëtar për vitin 2019 të dhëna përfundimtare dhe për vitin 2020, të dhëna paraprake.

- Tabela T1200 është përgatitur dhe dërguar në Eurostat për komponentët e PBB-së sipas veprimtarive të NKD Rev.2 në nivel rajonal për vitin 2019, të dhëna përfundimtare.

- Në vitin 2021, në kuadër të Programit rajonal IPA 2017, janë përgatitur në mënyrë plotësuese tabelat e mëposhtme:

- Zgjerimi i serive kohore për tabelën 0101 për PBB me çmime aktuale dhe me çmime konstante (1997-1999);

- Zgjerimi i serive kohore për tabelën 0102 për PBB me çmime aktuale dhe me çmime konstante (1997-1999);

- Përgatitja dhe transmittimi në Eurostat e tabelës 0101 - Bruto - vlera e shtuar me çmime aktuale - e rregulluar sezonalisht - nga tremujori i parë i vitit 2000 deri në tremujorin e fundit të publikuar;

- Përgatitja dhe transmittimi në Eurostat i tabelës 0101 - Bruto - vlera e shtuar në bazë - me çmime konstante - e rregulluar sezonalisht dhe e rregulluar për ditët e punës - nga 2000 q1 deri në tremujorin e fundit të publikuar;

- Përgatitja dhe transmittimi në Eurostat i tabelës 0102 – PBB sipas metodës së kostos – çmimet aktuale – të rregulluara sezonalisht dhe për ditët e punës– nga 2000 q1 deri në tremujorin e fundit të publikuar;

- Përgatitja dhe transmittimi në Eurostat e tabelës 0102 – PBB sipas metodës së kostos – çmimet aktuale – të rregulluara sezonalisht dhe të rregulluara për ditët e punës – nga tremujori i parë i vitit 2000 deri në tremujorin e fundit të publikuar;

- Përgatitja dhe transmittimi në Eurostat e tabelës 0102 – PBB sipas metodës së kostos – me çmime aktuale – të rregulluara sezonalisht – nga 2000 q1 deri në tremujorin e fundit të publikuar;

- Përgatitja dhe transmittimi në Eurostat e tabelës 0102 – PBB sipas metodës së kostos – me çmime konstante – të rregulluara sezonalisht dhe të rregulluara për ditët e punës – nga 2000 q1 deri në tremujorin e fundit të publikuar;

- Është përgatitur tabela 0117 - Konsumi final i ekonomive familjare sipas kohëzgjatjes, nga viti 2000 e në vazhdim, sipas konceptit të brendshëm - me çmime aktuale dhe konstante;

- Është përgatitur tabela 0301 - vlera e shtuar dhe përbërësit e saj me çmime konstante;

- Është përgatitur tabela 0501- Konsumi final i ekonomive familjare sipas qëllimit, me çmime aktuale nga viti 2000 e në vazhdim, sipas konceptit të brendshëm dhe me çmime konstante;

- Është përgatitur tabela 0502 - me çmime aktuale nga viti 2015 e në vazhdim dhe me çmime konstante.

- Në prill dhe tetor të vitit 2021, ishin përgatitur dhe dërguar deri tek Eurostat EDP-tabelat e njoftimit për periudhën 2017-2020, Pyetësorët (1-5) në lidhje me EDP – tabelat e njoftimit. Të dhënat janë përgatitur në përputhje me ESS 2010.
- Tabelat për ofertë dhe përdorim për vitin 2018, në përputhje me ESS 2010 – të dhënat përfundimtare, janë përgatitur, publikuar dhe dërguar në Eurostat.
- Janë përllogaritur dhe publikuar të dhënat për produktin e brendshëm bruto dhe investimet në asete fikse sipas rajoneve për vitin 2019, të dhënat përfundimtare dhe të dhënat paraprake për vitin 2020.
- Janë publikuar të dhënat e këmbimit të mallrave sipas karakteristikave ekonomike të ndërmarrjeve për vitin 2019 me aplikimin e kontrollit të konfidencialitetit.
- Në përputhje me konkluzionet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut nga prilli 2020, ESHS në bashkëpunim me FSSH publikoi Llogaritë kombëtare të shëndetësisë për vitin 2017 dhe 2018 dhe ofroi të dhëna për përpilimin e Llogarive kombëtare të shëndetësisë për vitin 2019 dhe 2020.
- Për të përmirësuar të dhënat për kostot e barnave, mjeteve ndihmëse të barnave, veglave mjekësore dhe produkteve të tjera mjekësore që qytetarët paguajnë privatisht, ESHS ka kryer një hulumtim me të cilën ka përfshirë të gjitha farmacitë e regjistruara në RMV dhe ka siguruar të dhëna për periudhën 2018-2020.
- Të dhënat rregullisht u dërgohen FMN-së në përputhje me standardin SDDS Plus.

Në fushën e tregtisë së jashtme të mallrave, gjatë vitit 2021 u kryen këto aktivitete:

- Duke filluar nga periudha referuese 01-03.2021, të dhënat e detajuara për tregtinë e jashtme të mallrave filluan të dërgohen rregullisht, në përputhje me orarin kohor të Eurostat-it, në formatin e ri GESMES.
- Të dhënat për TEK-un (eksportet dhe importet sipas karakteristikave ekonomike të ndërmarrjeve) për periudhën referuese 2018 janë përpunuar me konfidencialitet të aplikuar dhe janë dorëzuar në Eurostat në formatin SDMX.

2. Në programin Zbatimi i Regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, 2021, janë përcaktuar këto nënprograme:

- 2.1. Përgatitjet organizative dhe teknike
- 2.2. Zbatimi i fushatës mediatike
- 2.3. Realizimi i Regjistrimit
- 2.4. Përpunimi dhe desiminimi

Në kuadër të nënprogrameve të përcaktuara janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

2.1 Në përputhje me Ligjin për Regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 2021 ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 19/21 dhe 74/2021), dhe pas vendimit të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për shtyrjen e afatit të përcaktuar më parë për zbatimin e Regjistrimit të popullsisë në prill të vitit 2021 për shkak të pandemisë COVID-19, ESHS, në periudhën nga data 5 deri më 30 shtator (momenti kritik, 4 shtator 2021 ora 24:00), gati pas 20 vitesh ka realizuar me sukses Regjistrimin e popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në Republikën e Maqedonisë së Veriut, 2021 - veprim statistikor që paraqet prioritet me interes të lartë shtetëror si për vendin ashtu edhe për proceset integruese evropiane të vendit.

Angazhimet e forta në ESHS për aplikimin e metodës së re të kombinuar të regjistrimit (kombinimi duke përdorur të dhëna nga burimet administrative dhe regjistrimit në terren), aplikimi i teknologjisë së re me kompjuterë personal -(laptop), përmes metodës CAPI në vend të pyetësorëve në letër, patën ndikim të drejtpërdrejtë dhe të fortë për të gjithë procesin e përgatitjes dhe zbatimit të Regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave 2021 dhe të gjitha aktivitetet e planifikuara nga të gjitha nënprogramet u kryen në kohë.

Organizimi në terren filloi më 20 korrik 2021 - kur u rizgjodhën 50 komisionet e rajoneve të regjistrimit (KRR) në përputhje me Ligjin e Regjistrimit. Për të siguruar mbulimin sa më të mirë në terren dhe punë të pandërprerë, janë mbajtur disa takime para fillimit të aktivitetit në terren dhe është krijuar komunikim i rregullt me përfaqësuesit e KRR-së.

Shpallja për 506 instruktorë rajonal dhe 5055 regjistruar rajonal në nivel të 50 rajoneve të regjistrimit u shpall me 20 korrik dhe zgjati deri më 5 gusht 2021. Pas shpalljes së publikuar për instruktorë dhe regjistruar të rajonal (numri i kërkuar nuk u plotësua në 30 rrethe të regjistrimit), shpallja është ripërsëritur në periudhën prej 12.08.2021 deri më 17.08.2021. Numri i aplikuesve, sipas gjendjes 13.08.2021, ishte 4017. Testimi i aplikuesve është realizuar me 19 dhe 20.08.2021.

Në kohë (para fillimit të trajnimit), u shpërndanë 5650 laptopë, së bashku me materialet e nevojshme regjistruar dhe mjetet higjienike për t'i respektuar protokolet e COVID-19.

Në përputhje me dinamikën e planifikuar dhe strukturën e vendosur hierarkike të pjesëmarrësve për realizimin e regjistrimit në terren, u organizuan trajnime:

- për 150 instruktorë shtetërorë: 14-20.08.2021 në hapësirat e ESHS-së (organizuar në disa grupe për shkak të respektimit të protokoleve të COVID-19);

- për 350 instruktorë rajonal: 24. - 26. 08.2021;

- për 3700 regjistruar rajonal: 28. - 31.08.2021

2.2 Realizimi i fushatës mediatike

Fushata mediatike për promovimin e aktiviteteve të regjistrimit ka qenë rrjedhëse dhe e vazhdueshme si në vend ashtu edhe në diasporë. Pati mbulim mediatik pozitiv në fillim si dhe gjatë regjistrimit në terren për të promovuar kuptimin dhe rëndësinë e Regjistrimit për vendin, si dhe

informacione për risitë në metodën e regjistrimit, mbrojtjen e të dhënave personale, regjistrimit të sigurt dhe respektimit të protokoleve të regjistrimit në kushtet e një pandemie të COVID-19.

Fushata mediatike u ndikua nga shtyrja e Regjistrimit nga muaji prill në shtator 2021. Gjegjesisht, të gjitha produktet që ishin paraparë me fushatën (video dhe radioklipe, pankarta, billborde, postera, reklama në web, postime në rrjete sociale, hapësira të marra me qira në portale, billborde me qira) u përgatitën dhe u shfaqën në etër. Menjëherë pas shtyrjes së Regjistrimit, të gjitha aktivitetet mediatike u ndërprejnë dhe më vonë u bë një prokurim i ri publik për një tjetër fushatë shtesë për të kompensuar gjithçka që dështoi me shtyrjen e Regjistrimit.

Fushata mediatike përbëhej nga produkte të ndryshme, përkatësisht:

- Vendosja e bilbordeve në gjithë territorin e vendit;
- Në qytetin e Shkupit në linjat më të shpeshta qarkullonin autobusë me reklama nga Regjistrimi;
- Qendrat e mëdha tregtare u markuan me reklama dhe shkrime për Regjistrimin;
- Në portalet më të lexuara të internetit, çdo ditë kishte reklama për Regjistrimin;
- Shfaqje radiofonike për Regjistrimin e popullsisë u transmetuan disa herë në ditë në stacionet radiofonike, si në nivel kombëtar ashtu edhe në atë lokal;
- Në ekranin e madh në sheshin qendror në Shkup, videoreklammat për Regjistrimin 2021 u transmetuan çdo 15 minuta në 7 gjuhë;
- Në të gjithë territorin e vendit u vendosën postera dhe në qytetet e mëdha u vendosën dorhengerë;
- Sipas një orari të parapërgatitur, njoftimet dhe videot postoheshin në: FB, Instagram dhe kanalin YouTube, edhe atë për çdo ditë, nga data 25 gusht deri më 30 shtator.
- Lidhur me aktivitetet e marrëdhënieve me publikun, më 4 shtator u organizua një konferencë për media si paralajmërim për fillimin e regjistrimit, ndërsa më 5 shtator në dy lokacione në Shkup, në prani të mediave, u shënuar fillimi i aktiviteteve të Regjistrimit në terren.
- Në ESHS u organizua një qendër mediatike, e cila funksionoi çdo ditë me një orar prej 12 orëve, për nevojat e raportimit në kohë të publikut dhe për tu përgjigjur pyetjeve të popullatës.

2.3 Pavarësisht sfidave të shumta me të cilat u përballëm, rezultati ishte i dukshëm:

- Ishin të përfshira mbi 90.6% e objekteve të banimit, 9.0 ishin objekte që nuk ishin njësi regjistrimi dhe vetëm 0.4 nuk ishin të përfshira.

- Janë regjistruar:

- 1,832,696 persona,

- 568.175 ekonomi familjare dhe

- 837.255 banesa.

-Gjithashtu, 204.805 qytetarë të Republikës së Maqedonisë së Veriut kanë shfrytëzuar mundësinë e vetëregjistrimit nga jashtë vendit përmes aplikacionit të disponueshëm në webfaqen Popis2021.

2.4 Përpunimi i të dhënave të regjistrimit në përgjithësi përbëhet nga disa procedura statistikore me qëllim kryesor prodhimin e rezultateve cilësore të regjistrimit, në përputhje dhe duke respektuar kriteret bazë të cilësisë: mbulimin, relevancën dhe koherencën, si dimensionet më të rëndësishme për cilësinë e të dhënave statistikore. Krahasuar me metodën tradicionale të regjistrimit, përpunimi i të dhënave të Regjistrimit me metodën e re të kombinuar të regjistrimit është më i ndërlikuar dhe më kompleks, por mundëson redaktimin sistematik më të shpejtë dhe të kontrolluar të të dhënave, sepse të gjitha bazat e të dhënave hyrëse tashmë ekzistojnë në formë elektronike. Dallimi kryesor është se përballë një baze të të dhënave hyrëse nga regjistrimi në terren në metodën tradicionale të regjistrimit, në metodën e kombinuar të regjistrimit ekzistojnë gjashtë baza të të dhënave hyrëse që kombinohen dhe duhet të përpunohen.

Në përputhje me Ligjin për Regjistrim dhe metodologjinë e regjistrimit, ESHS ka miratuar një Program për përpunimin dhe publikimin e të dhënave. Sipas këtij Programi, ESHS kishte obligim brenda një periudhe gjashtëmuajore pas përfundimit të Regjistrimit, d.m.th. deri më datë 30.03. 2022 për të publikuar rezultatet e para përfundimtare të Regjistrimit 2021. Gjithashtu, rezultatet e përpunimit, sipas Programit, janë publikuar në përputhje me dinamikën e planifikuar të publikimit sipas karakteristikave të veçanta të njësive të Regjistrimit (persona, ekonomi familjare dhe banesa).

Afati i fundit për publikimin e të dhënave të regjistrimit sipas karakteristikave individuale ishte dhjetor 2022.

3. Në programin e Mjedisit institucional janë përcaktuar nënprogramet e mëposhtme:

3.1.. Miratimi i një Programi për hulumtime statistikore

3.2 Realizimi i rolit të Komitetit koordinues

3.3 Përdorimi i burimeve të të dhënave administrative

Në kuadër të nënprogrameve të përcaktuara janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Është mbajtur punëtori për planifikimin dhe përgatitjen e Programit të hulumtimeve statistikore 2023-2027;
- U formuan grupet punuese për përgatitjen e Programit pesëvjeçar për hulumtime statistikore 2023-2027;
- Janë përgatitur 17 dokumente lidhur me Programin, disa prej të cilave janë miratuar në seancën e Kolegiumit profesional (Plani për përgatitjen e Programit për hulumtime statistikore, Struktura e programit, Procedura për ndryshimin dhe plotësimin e Programit, Formulari për ndryshimin dhe plotësimin e Programit, Pyetësori për bartësit);
- Është bërë evaulimi i rolit dhe kontributit të bartësve të autorizuar në sistemin statistikor në drejtim të riaktivizimit të Komitetit koordinues;
- Është mbajtur takim në kuadër të sektorit të TI-së për administrimin dhe menaxhimin e të dhënave administrative. Si përfundim u nxjerr se nevojitet një analizë e detajuar e secilit burim përpara se të fillohet me riorganizimin e strukturës burimore.

4. Në programin e Infrastrukturës statistikore janë përcaktuar nënprogramet e mëposhtme:

4.1 Klasifikimet/nomenklaturat

4.2.Punonjësit-mbindërtimi i kapaciteteve të punonjësve

4.3 Infrastruktura e informacionit

Në kuadër të nënprogrameve të përcaktuara janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Klasifikimi i konsumit personal sipas qëllimit (KLPN 2021), bazuar në COICOP 2018, u miratua dhe u publikua në webfaqen e internetit të ESHS-së.
- Në kontekst të strukturës së informacionit, ESHS ka zbatuar aktivitete në kuadër të IPA 2017, të cilat janë vonuar për arsye të ndryshme (COVID-19 dhe pamundësia e mbajtjes së takimeve dhe konsultimeve fizike, vështirësitë në sigurimin e ekspertëve të TI-së dhe largimi i tyre gjatë projektit; angazhimi i personave të TI-së nga Enti për aktivitetet e regjistrimit etj.).
- Aktiviteti për modelimin logjik të sistemit të informacionit statistikor dhe përshkrimin e detajuar të funksionaliteteve është kryer në periudhën e përcaktuar nga kontraktori me bashkëpunimin aktiv të punonjësve të ESHS-së.
- Aktiviteti i planifikuar: Dizajnimi i një sistemi të TI-së bazuar në meta të dhëna për grumbullimin dhe përpunimin e të dhënave është punuar me një vonesë të madhe prej një viti.
- Kishte përfunduar dizajni i tre moduleve:
 - Përpunimi i një zgjidhjeje aplikimi për Programin vjetor dhe Programin pesëvjeçar për hulumtime statistikore (GP dhe 5GP),
 - Modul për klasifikimet dhe listat koduese,
 - Moduli për menaxhimin me përdoruesit.
- Është bërë testimi, por vetëm në 3 modulet e para.
- Është punuar në modulin për Përgatitjen dhe grumbullimin e të dhënave.
- Në vitin 2021 janë realizuar disa trajnime për mbindërtimin e punonjësve të ESHS-së. Trajnimet ishin në fushën e statistikave, si dhe në fusha të tjera që kanë karakter të përgjithshëm. Për shkak të situatës me pandeminë, shumica e trajnimeve janë zhvilluar online.

5. Në programin e Bashkëpunimit me ofruesit e të dhënave dhe bartësit e grupeve të të dhënave është përcaktuar nënprogrami i mëposhtëm:

5.1 Përgatitja e marrëveshjeve të reja ose përditësimi i memorandumeve ekzistuese dhe marrëveshjeve për bashkëpunim

Në vitin 2021 theksi u vu në realizimin e marrëveshjeve dhe memorandumeve tashmë të lidhura nga aspekti i nevojave të Regjistrimit. Në këtë kuptim, është lidhur një aneks i marrëveshjes tashmë ekzistuese për këmbimin e të dhënave me Ministrinë e Punëve të Brendshme, si dhe një aneks i marrëveshjes me Bankën Popullore të Republikës së Maqedonisë së Veriut për sigurimin e të dhënave nga statistikat e fushës së shërbimit.

Është nënshkruar një memorandum bashkëpunimi me Ministrinë e Punës dhe Politikës Sociale dhe në bazë të këtij dokumenti janë dorëzuar grupe të mikro të dhënave me të cilat disponon Enti dhe të

cilat sipas dinamikës së planifikuar ia dorëzon Eurostatit, ndërsa i referohen të dhënave nga Anketa e Forcës së Punës.

6. Në programin Bashkëpunimi dhe komunikimi me përdoruesit janë përcaktuar nënprogramet e mëposhtme:

6.1 Avancimi dhe desiminimi i shërbimeve dhe futja e produkteve të reja

6.2 Prezenca në mediat sociale

6.3 Zhvillimi i mjeteve për rritjen e njohurive statistikor

Në kuadër të nënprogrameve të përcaktuara janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Enti Shtetëror i Statistikës përgatiti dhe miratoi Komunikimin e ri të strategjisë së institucionit, i cili u zhvillua në kuadër të projektit me Entin Suedez të statistikave (financuar nga SIDA). Strategjia e re e Komunikimit hedh bazat për zhvillimin e formave të reja të desiminimit dhe komunikimit të produkteve statistikore dhe do të kontribuoj në përmirësimin e imazhit të institucionit në publik.

- Për t'i bërë më të aksesueshme të dhënat statistikore, është rifutur edicioni Infografik përmes të cilit, në mënyrë vizuale dhe të thjeshtë, tërheqin vëmendjen e përdoruesit ekzistues dhe potencial që të vizitojnë faqen e internetit të ESHS-së dhe të përdorin të dhënat. Ky edicion ngjalli interes të madh publik dhe infografikët ndiqet rregullisht nga mediat.

- Për qëllimet e Regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave 2021, u hap një faqe e veçant interneti e dedikuar për gjithçka që lidhet me Regjistrimin dhe nëpërmjet së cilës përdoruesit mund të njihen me të gjitha aspektet e Regjistrimit, si dhe të informohen vazhdimisht për të gjitha zhvillimet lidhur me Regjistrimin.

- Për sa i përket rrjeteve sociale, Enti ishte aktiv në faqen e tij në FB, ndërsa që nga fillimi i Regjistrimit (mesi i vitit) u hap një llogari e Entit edhe në Instagram, ku postoheshin rregullisht përmbajtje të lidhura me statistikën.

Gjatë vitit 2021, u mbajtën një sërë seminaresh që iu dedikuan promovimit të rëndësisë së Regjistrimit, shpjegimit të Metodologjisë së Regjistrimit dhe, në përgjithësi kuptimit dhe rëndësisë së të dhënave të Regjistrimit.

7. Në programin Përkushtimi ndaj cilësisë janë përcaktuar këto nënprograme:

7.1. Rishikimi i dokumenteve të lidhura me cilësinë

7.2. ISO-certifikatë

7.3. Vlerësimi i partneritetit

Në kuadër të nënprogrameve të përcaktuara janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

- Është bërë vlerësimi i rëndësisë së dokumenteve strategjike ekzistuese në fushën e cilësisë dhe është vlerësuar se është i nevojshëm rishikimi i tyre për shkak të auditimeve të bëra në Kodin Evropian të praktikës së mirë, përcaktimi i Kornizës së re të vlerësimit të cilësisë në Sistemin statistikor evropian dhe ndryshimet në planifikimin strategjik të institucionit. Bazuar në këtë analizë, u rishikuan dhe përgatitën disa dokumente të reja: Deklarata e cilësisë (dokumenti i ri), Politika e cilësisë (dokumenti i rishikuar) dhe filloi përpunimi i web kapitullit për cilësi.

- Në lidhje me certifikimin ISO janë kryer aktivitete përgatitore. Domethënë, është përgatitur Manuali për auditimin e brendshëm të cilësisë dhe duke ndjekur Manualin dhe anekset është kryer auditimi i cilësisë së Anketës së konsumit të energjisë në ekonominë familjare. Gjithashtu, ka filluar studimi i procedurës së kërkuar për certifikimin ISO.

- Eurostat filloi procesin e Vlerësimit të partneritetit me zbatimin në 4 institucione statistikore që testuan procesin në kufizimet e imponuara të shkaktuara nga pandemia. Akoma nuk është marrë vendimi për përfshirjen e Entit Shtetëror të Statistikave në këtë raund të vlerësimit të partneritetit dhe për këto arsye tash për tash vetëm është duke u ndjekur procesi dhe janë duke u studiuar dokumentet përkatëse të përgatitura nga Eurostati.

1.11. VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I REZULTATEVE TË ARRITURA NGA ENTI SHETËROR I STATISTIKËS NË 2022

Në Planin strategjik të Entit Shtetëror të Statistikës për periudhën 2022-2024 janë përcaktuar këto programe lidhur me realizimin e prioriteteve strategjike të Entit Shtetëror të Statistikave (në tekstin e mëtejme: ESHS).

1. Statistikat sektoriale
2. Zbatimi i Regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave në vitin 2021
3. Mjedisi institucional
4. Infrastruktura statistikore
5. Bashkëpunimi me ofruesit e të dhënave dhe bartësit e grupeve të të dhënave
6. Bashkëpunimi dhe komunikimi me përdoruesit
7. Përkushtimi ndaj cilësisë

Realizimi i këtyre programeve ka të bëjë me prioritetin strategjik të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022 për zhvillimin e suksesshëm të bisedimeve për anëtarësim në Bashkimin Evropian, që gjendet në Vendimin për përcaktimin e prioriteteve strategjike të Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut për vitin 2022, gjegjësisht qëllimet prioritare: fillimi dhe menaxhimi i suksesshëm i procesit negociator për anëtarësimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në Bashkimin Evropian, zbatimi i politikës makroekonomike që synon ruajtjen e stabilitetit makroekonomik, rritjen e konkurrencës së ekonomisë dhe rritjen e punësimit.

1. Në programin e Statistikave sektoriale janë përcaktuar nënprogramet e mëposhtme:

1.1 Përmirësimi i procesit të prodhimit të statistikave sektoriale

1.2 Matja e cilësisë së njoftimeve

Në kuadër të nënprogrameve të përcaktuara janë realizuar aktivitetet e mëposhtme:

Statistikat sociale

- Në fushën Forca e Punës, implementimi i rregullores IESS në Anketën e Forcës së Punës vazhdoi edhe në vitin 2022. Një bazë të dhënash mbi punësimin informal, seri sipas tremujorëve dhe viteve, që për herë të parë u publikuan në bazën e të dhënave Makstat. Me kërkesë të Institutit të Vjenës për studime ekonomike ndërkombëtare, u përgatit një sërë të dhënash të papublikuara sipas karakteristikave dhe kryqëzimeve të ndryshme të Anketës së Forcës së Punës.
- Metodologjia dhe instrumentet në fushën e Arsimit dhe Trajnimit për Anketën e Arsimit për të Rritur, të cilat u përgatitën në vitin 2021, u finalizuan në mes të qershorit të vitit 2022 për arsye që Eurostat-i vazhdimisht i ndryshonte. Me aktivitetet në terren, për Anketën, është filluar në muajin tetor dhe është përfunduar kah fundi i muajit dhjetor 2022.
- Është realizuar Anketa e Konsumit të Ekonomive Familjare (AKEF) në terren në një mostër prej 5040 ekonomi familjare. Në vazhdimësi janë kontrolluar dhe analizuar përlllogaritjet tremujore dhe vjetore, të ardhurat dhe shpenzimet e ekonomive familjare nga Anketa e konsumit të ekonomive familjare. Të dhënat nga AKEF-i 2021 u publikuan në bazën e të dhënave Makstat dhe publikimet të tjera të multi fushave.
- Kanë përfunduar aktivitetet përgatitore për Anketën e Përdorimit të Kohës (APK) që do të realizohet në vitin 2023.
- Ndiqen ndryshimet në metodologjinë për harmonizimin e indeksit të kostos së jetesës në lidhje me këtë hulumtim në IPA 2019, dhe u publikuan njoftimet mujore dhe të dhënat e tabeluara në bazën e të dhënave Makstat dhe në publikime të tjera mujore dhe vjetore të multi fushave, si dhe të dhënat për Indeksin e Harmonizuar të Kostos së Jetesës transmitohen çdo muaj në Eurostat.
- Është Realizuar Anketa mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës (AAKJ) 2022 në terren, në një mostër prej rreth 6800 ekonomive familjare, e cila ndjek plotësisht rekomandimet dhe rregulloret e BE-së. Janë realizuar të gjitha aktivitetet e këtij hulumtimi, si dhe kontrolli dhe analiza e të dhënave të Anketës mbi të Ardhurat dhe Kushtet e Jetesës (AAKJ) të realizuara në vitin 2021. U përgatitën tabelat për AAKJ 2021 dhe publikimi për Treguesit e Varfërisë në Laeken 2021 dhe të dhënat u dërguan në Eurostat.
- Për herë të parë është realizuar Anketa mbi dhunën me bazë gjinore.
- Është realizuar Anketa e trajnimit të vazhdueshëm profesional.

Statistikat bujqësore

- Në fushën e statistikave bujqësore, është realizuar Regjistrimi Testues i Bujqësisë, nga data 15 deri më 30 qershor 2022. Metodologjia për Regjistrimin ishte plotësisht në përputhje me rregulloren e BE-së 2018/1091 për statistikën e integruar bujqësore, si dhe me Manualin ESS për statistikën e integruar bujqësore. Në fushën e statistikave të mjedisit jetësor ishin të krijuara faturat e para të energjisë duke përdorur veglën PEFA Builder.
- Janë bërë përlllogaritje eksperimentale në llogari të pylltarisë dhe për sigurimin e inputit me të dhëna, si dhe janë bërë korrigjime të formularëve statistikore në fushën e pylltarisë.

- Në fushën e statistikave energjetike janë bërë vlerësime për përmirësimin e përfshirjes së bilanceve energjetike duke përcaktuar burimet e të dhënave për llojet e reja të energjisë.

Statistikat afariste

- Në statistikatat afariste, edhe gjatë vitit 2022, ka vazhduar procesi i përshtatjes me dispozitat e rregullores së EBS-së (European Business Statistics), rregulloren për statistikatat afariste, respektivisht Rregulloren e BE-së 2019/2152 e Parlamentit dhe Këshillit Evropian të datës 27 nëntor 2019, për statistikatat afariste evropiane, me anë të cilës u shfuqizuan 10 akte ligjore në fushën e statistikave afariste.
- Në fushën e Regjistrimit statistikor afarist, i cili paraqet bazë për statistikatat afariste, në kuadër të projektit IPA 2017, në vitin 2022 u finalizuan aktivitetet dhe u përgatit një dizajn i ri logjik i regjistrimit, i cili përmirësoi funksionalitetin e Regjistrimit për sa i përket dhënies së njësive statistikore të detyrueshme dhe variablave të tyre (sipas EBS - ndërmarrje komplekse ku disa njësi ligjore janë të lidhura në një ndërmarrje komplekse dhe KAU - njësi sipas llojit të veprimtarisë, përditësimit dhe përdorimit të saj për nevojat e hulumtimeve statistikore (kryesisht, për demografinë e ndërmarrjeve dhe për statistikatat IFATS). Për sa i përket demografisë së ndërmarrjeve, gjatë vitit 2022 ndjeshëm u rrit vëllimi i të dhënave të dorëzuara në Eurostat. Në vitin 2022 u zbatua dizajni i ri logjik, respektivisht vënien në funksion të aplikacionit dhe përpunimin e të dhënave përfundimtare për vitin 2021.
- STS dhe SDS, respektivisht statistikatat afatshkurtra dhe statistikatat strukturore afariste, u përshtatën gjithashtu me dispozitat e rregullores EBS, në drejtim të rritjes e përfshirjes së variablave të kërkuara sipas Rregullores, si dhe grupin e të dhënave të dorëzuara në Eurostat. Në vitin 2022 filluan aktivitetet në kuadër të IPA 2019 – të cilat synojnë avancimin dhe harmonizimin e mëtejshëm të hulumtimeve tashmë ekzistuese dhe publikimin e rregullt të variablave STS dhe dorëzimin e tyre në Eurostat.
- U zbatua hulumtimi i dytë pilot për prodhimin e statistikave të tregtisë ndërkombëtare të shërbimeve (ITSS) dhe përpunimi i të dhënave pilot u dorëzuan në Eurostat.

Statistikat makroekonomike

Në fushën e statistikave makroekonomike janë bërë përpjekje të vazhdueshme për përmirësimin e të dhënave në përputhje me CHC 2008 (System of National Accounts, SNA 2008) dhe ECC 2010 (European System of Accounts, ESA 2010) dhe transmissioni i tyre në Eurostat:

- Në vazhdimësi janë dërguar në Eurostat të dhënat për tabelat kryesore sipas Programit të Transmisionit ESS 2010, edhe atë në nivel vjetor dhe tremujor, T0101 dhe T0102, në përputhje me Rregulloren nr. 549/2013;

- Janë përgatitur dhe dërguar në Eurostat Tabelat (T1001 dhe T1002) për komponentët e PBB-së sipas veprimtarive të NKD Rev.2 në nivel kombëtar për vitin 2020 të dhëna përfundimtare, dhe për vitin 2021, të dhëna paraprake;
- Ishte përgatitur dhe dërguar në Eurostat Tabela T1200 për komponentët e PBB-së sipas veprimtarive të NKD Rev.2 në nivel rajonal për vitin 2020, të dhënat përfundimtare.

Në vitin 2022, në kuadër të IPA 2019 MBP, janë përgatitur tabelat e mëposhtme:

- Është përgatitur dhe transmituar në Eurostat tabela 0101 - Bruto - vlera e shtuar me çmime aktuale dhe me çmime konstante - e rregulluar sezonalisht - nga 2000 kv1 deri në tremujorin e fundit të publikuar - vazhdon si transmision i rregullt;
- Është përgatitur dhe transmituar në Eurostat tabela 0102 - PBB sipas metodës së kostos - me çmime aktuale dhe me çmime konstante - e rregulluar sezonalisht dhe e rregulluar për ditë pune - nga 2000 kv1 deri në tremujorin e fundit të publikuar - vazhdon si transmision i rregullt;
- Është përgatitur dhe transmituar në Eurostat tabela 0800 - Llogaritë vjetore sektoriale për periudhën 2012-2020;
- Janë përgatitur dhe transmituar në Eurostat: tabela 0200 - Agregatët kryesorë të shtetit, 0900 - Taksat e detajuara dhe të ardhurat nga kontributet sociale sipas llojeve të taksave dhe kontributeve sociale dhe nënsektorit për pranim dhe Lista Kombëtare e taksave për periudhën 2011- 2020;
- Është përditësuar tabela T0117 - Konsumi përfundimtar i ekonomive familjare sipas kohëzgjatjes, në nivel vjetor, sipas konceptit vendor - me çmime aktuale;
- Është përgatitur tabela 0301 - vlera e shtuar dhe përbërësit e saj me çmime konstante;
- Është përditësuar tabela T0501 - Konsumi përfundimtar i ekonomive familjare sipas qëllimit, në nivel vjetor, me çmime aktuale, sipas konceptit vendor;
- Është përditësuar tabela T0502 - Konsumi përfundimtar i ekonomive familjare sipas kohëzgjatjes, në nivel vjetor, sipas çmimeve aktuale.

Aktivitete të tjera në fushën e statistikave makroekonomike të realizuara në vitin 2022:

- Në prill dhe tetor të vitit 2022, janë përgatitur dhe dërguar në Eurostat EDP- tabelat e njoftuese për periudhën 2018-2021, Pyetësorët (1-5) në lidhje me tabelat njoftuese të EDP-së. Të dhënat janë përgatitur në përputhje me ESS 2010.
- Tabelat për ofertë dhe përdorim për vitin 2019, në përputhje me ESS 2010 – të dhënat përfundimtare, janë përgatitur, publikuar dhe dërguar në Eurostat.
- Janë përlllogaritur dhe publikuar të dhënat për produktin e brendshëm bruto dhe investimet në asetet fikse sipas rajoneve për vitin 2020, të dhënat përfundimtare dhe të dhënat paraprake për vitin 2021.
- Janë përlllogaritur dhe publikuar të dhënat për llogaritë shëndetësore për vitin 2019 dhe 2020.

Në fushën e tregtisë së jashtme të mallrave gjatë vitit 2022 janë zhvilluar këto aktivitete:

- Janë publikuar të dhëna për këmbimin e mallrave sipas karakteristikave ekonomike të ndërmarrjeve (TEK) për vitin 2020 me zbatimin e konfidencialitetit aktiv.

- Të dhënat për TEK (këmbimin e mallrave sipas karakteristikave ekonomike të ndërmarrjeve) për periudhën referuese 2019 janë përgatitur me zbatimin e konfidencialitetit aktiv dhe janë dorëzuar në Eurostat në formatin SDMX.
- Për statistikën e këmbimit të mallrave sipas valutës së faturuar, të dhënat për periudhën referuese 2021 janë përpunuar dhe janë dorëzuar në Eurostat në përputhje me Udhëzimet Metodologjike më të fundit për statistikën evropiane të biznesit mbi tregtinë sipas monedhës së faturuar (TFV).
- Tabelat për përgatitjen e raportit të cilësisë nga Eurostat janë dorëzuar në kohë. Gjatë vitit 2022 filloi plotësimi i raporteve për cilësinë e statistikave të këmbimit të mallrave - të dhëna të detajuara dhe këmbimin e mallrave sipas karakteristikave ekonomike të ndërmarrjeve në Eurostat, duke përdorur veglën ESS-MH aplikacionin (ESS Metadata Handler application). Rregullisht janë dërguar të dhëna FMN-së në përputhje me standardin SDDS Plus.

2. Në programin Realizimi i Regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave 2021 ishte i definuar programi në vijim:

2.1. Përpunimi dhe desiminimi

Në kuadër të këtij programi, në lidhje me aktivitetet e planifikuara, ishte realizuar programi në vijim:

- Programi për publikimin e të dhënave nga Regjistrimi, 2021,
- Ishin të publikuara rezultatet nga zbatimi i Regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave, 2021 sipas Programit për publikimin e të dhënave.

Në kuadër të programeve të definuara, ishin të realizuar aktivitetet në vijim:

3. Në programin Mjedisi institucional ishin të definuara programet në vijim:

3.1. Miratimi i Programit për hulumtime statistikore

Në kuadër të përcaktimit të nënprogrameve ishin të realizuar aktivitetet në vijim:

Nënprogrami “Miratimi i Programit për Hulumtime Statistikore, 2023-2027” ka përfunduar në tërësi. Gjatë vitit 2022 janë zhvilluar një sërë takimesh me përdoruesit dhe bartësit. U mbajt punëtorja me temë: Programi për hulumtime statistikore, 2023-2027-nevojat, mundësitë, sfidat dhe perspektivat. Këshilli i Statistikave është informuar rregullisht për procesin e përgatitjes dhe statusin e Programit; Hulumtimi është futur në zgjidhjen e aplikacionit dhe Programi është dorëzuar në Qeverinë e Republikës së Maqedonisë së Veriut për miratim.

4. Në programin Infrastruktura statistikore ishin të përcaktuara nënprogramet në vijim:

4.1.Klasifikime/nomenklatura

Në kuadër të këtij nënprogrami ishin të realizuara aktivitetet në vijim, respektivisht u miratuan:

- NNIP Klasifikimi nacional i prodhimeve industriale, 2021
- Klasifikimi standard i tregtisë, SMTK, 2022
- Klasifikimi sipas kategorive themelore ekonomike, OEK 2022

4.2. Të punësuarit-mbindërtimi i kapaciteteve të të punësuarve

Në vitin 2022 janë realizuar disa trajnime për mbindërtimin e aftësive të punonjësve të ESHS-së. Trajnimet ishin nga fusha e statistikave, si dhe nga fusha të tjera që kanë karakter të përgjithshëm.

Në vitin 2022, Enti Shtetëror i Statistikave ka vazhduar të forcojë kapacitetet e punonjësve me pjesëmarrje aktive në ngjarjet ndërkombëtare.

Në 95 trajnime (trajnime të jashtme – misione ekspertësh, vizita studimore, punëtori, seminare, kurse trajnimi etj.), të organizuara nga ekspertë të jashtëm, morën pjesë 342 pjesëmarrës, dhe në 109 takime gjithsej, kishte 198 pjesëmarrës nga ESHS.

4.3.Infrastruktura informatike

Lidhje me infrastrukturën informatike, gjatë vitit 2022 vazhduan aktivitetet të cilët patën filluar një vit më herët.

5. Në programin Bashkëpunimi me ofruesit e të dhënave dhe me bartësit e koleksioneve të të dhënave ishte përcaktuar programi në vijim:

5.1. Bashkëpunimi me ofruesit e të dhënave dhe bartësit e koleksioneve të të dhënave

Në vitin 2022 theksi ishte vënë në realizimin e tashmë kontratave të realizuara dhe memorandumëve me bartësit e autorizuar, përdoruesit dhe bartësit e koleksioneve administrative të të dhënave.

Kishim intenzivim të aktiviteteve në lidhje me përgatitjen e kontratave me Bankën Popullore të RMV-së dhe Drejtorinë e të Hyrave Publike.

6. Në programin Bashkëpunimi dhe komunikimi me përdoruesit ishin përcaktuar nënprogramet në vijim:

6.1.Avancimi i shërbimeve të desiminimit dhe futjen e prodhimeve të reja

6.2.Prezenca e mediave sociale

6.3.Zhvillimi i mjeteve për rritjen e njohurive statistikore

Në kuadër të nënprogrameve të përcaktuara ishin realizuar aktivitetet në vijim:

- Gjatë vitit 2022, Enti Shtetëror i Statistikave shpalli rezultatet e Regjistrimit të popullsisë, ekonomive familjare dhe banesave 2021, sipas Programit për përpunimin dhe publikimin e të dhënave. Në periudhën nga data 30 mars deri në fund të vitit 2022, të gjitha të dhënat nga Regjistrimi janë publikuar në disa grupe që janë vendosura në faqen e internetit të ESHS-së. Në të njëjtën kohë, në bashkëpunim me UNFPA, është përgatitur dhe shtypur publikimi “Popullsia e përgjithshme rezidente në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Regjistrimi 2021”, ndërsa Enti Shtetëror i Statistikave ka përgatitur dhe publikuar Atlasin Statistikor në të cilin janë të dhënat nga Regjistrimi i vitit 2021 të paraqitura përmes hartave tematike.
- Në kuadër të projektit me Entin e Statistikave Suedeze (financuar nga SIDA), Enti Shtetëror i Statistikave filloi me ridizajnimin dhe përmirësimin e faqes së internetit. Baza e të dhënave Makstat është përmirësuar gjithashtu me shkarkimin e versionit më të fundit të Px Web.
- Në kuadër të bashkëpunimit me UN Women, është bërë analizë e statistikave gjinore të prodhuara nga Enti Shtetëror i Statistikave dhe gjetjet u prezantuan në një publikim që shërben si bazë për përmirësime të mëtejshme të këtyre statistikave. Ka filluar krijimi i një web-platforme për prezantimin e statistikave gjinore dhe në mars të vitit 2023 do të publikohet edicioni më i ri i publikimit “Gratë dhe Burrat në Maqedoninë e Veriut”, i cili do të jetë tërësisht i ridizajnuar dhe me përmbajtje të pasuruar.
- Prezenca në mediat sociale vazhdon të jetë një objektiv i rëndësishëm i Entit duke pasur parasysh rëndësinë dhe rolin që luajnë rrjetet sociale në mjedisin e sotëm. Enti përpiqet të jetë në hap me kohën dhe të kënaqë nevojat dhe interesat e të gjithë përdoruesve të të dhënave statistikore.
- Në vitin 2022 ka vazhduar puna e Entit për planin e ndërgjegjësimit për njohuri dhe përdorimin e të dhënave statistikore. Gjatë gjithë vitit, përfaqësues të ESHS-së morën pjesë në punëtori ku u prezantua përdorimi i bazës së të dhënave MakStat, veçanërisht pjesa për Regjistrimin 2021 si tema më aktuale dhe me të dhënat më të kërkuara për vitin 2022.

7. Në programin Përkushtim ndaj cilësisë ishin të përcaktuara nënprogramet në vijim:

7.1 Revidimi i dokumenteve të lidhura me cilësinë

7.2.ISO-sertifikat

7.3.Vlerësim partneriteti

Në kuadër të nënprogrameve të përcaktuara janë realizuar aktivitetet në vijim:

- Është bërë vlerësimi i rëndësisë së dokumenteve strategjike ekzistuese në fushën e cilësisë dhe është vlerësuar se është i nevojshëm rishikimi i tyre për shkak të auditimeve të bëra në Kodin Evropian të Praktikës së Mirë, përcaktimin e cilësisë së re dhe ndryshimet në

planifikimin strategjik të institucioneve. Bazuar në këtë analizë, u rishikuan dhe përgatitën disa dokumente të reja: u miratua Deklarata e Cilësisë (dokument i ri), u miratua Politika e Cilësisë (dokument i rishikuar) dhe u përpiluar web kapitull cilësor.

- Në lidhje me certifikimin ISO janë kryer aktivitete përgatitore. Pra, u përgatit një Manual i Auditimit të Brendshëm të Cilësisë dhe duke ndjekur Manualin dhe anekset, u formua një ekip i Auditimit të Brendshëm të Cilësisë, i cili gjithashtu mori trajnimin e duhur, u realizua auditim cilësor i Anketës së Konsumit të Energjisë së Ekonomive Familjare, ndërsa në fund të vitit 2022 u miratua Plani i parë për auditimet e brendshme të cilësisë, 2023.
- Vitin e kaluar Eurostat filloi procesin e Vlerësimit të Partneritetit me realizim në 4 institucione statistikore të cilat testuan procesin në kufizime të modifikuara të shkaktuara nga pandemia. Enti Shtetëror i Statistikave ka paraqitur një kërkesë në Eurostat për t'u përfshirë në Vlerësimin e Partneritetit në vitin 2025.

1.12. PROGRAMET

Për arritjen e prioriteteve dhe synimeve të planifikuara të Planit Strategjik 2023-2025 janë përcaktuar këto programe me nënprograme:

1. Statistika sektoriale
2. Realizimi i Regjistrimit të bujqësisë, 2023
3. Infrastruktura statistikore
4. Bashkëpunimi dhe komunikimi me përdoruesit
5. Përkushtim ndaj cilësisë.

Realizimi i të gjitha programeve kërkon angazhimin e burimeve të duhura njerëzore dhe financiare, dhe dinamika e realizimit të tyre përcaktohet në Planin e zbatimit të programit, i cili është pjesë përbërëse i këtij dokumenti.